



## PROCESVERBALI

Nga mbledhja e dytë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 28.02.2024 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në ora 10:00.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje janë të pranishëm 19 asamblastë dhe se ka kuorum.

Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësuesit e KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, nënkryetari për komunitete, drejtorët e drejtorive komunale: për Buxhet dhe Financa, për Arsim dhe Kulturë, për Planifikim, Urbanizëm dhe mbrojtjen e Mjedisit, për Zhvillimin Ekonomik dhe Integritet, Shërbimi për Përkthim, Shërbimi për Informim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblastët se është mbajtur mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa para mbledhjes së sotme të Kuvendit dhe se Komiteti njëzëri e ka dhënë mendimin pozitiv për rendin e propozuar të ditës me dy pika plotësuese:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit preliminar për fillimin e procedurës për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër – lokalet në Suhadoll, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e propozuar të ditës me dy pika plotësuese:

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblastëve “Pro”, miratoi rendin e propozuar të ditës.**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e rregullt, e mbajtur më datën 31.01.2024.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2023, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për miratimin e marrëveshjes kornizë për bashkëpunim ndërkomunal shumëfunktional, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës për vitin 2023, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq.
5. Informata për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë dhe fillimit të gjysmëvjetorit të dytë shkollor 2023/2024, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve Evropiane, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve Evropiane, Nebojsha Millovanoviq.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit preliminar për fillimin e procedurës për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër – lokalet në Suhadoll, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e rregullt, e mbajtur më datën 31.01.2024.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2023, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se buxheti fillestar ishte 8.767.000 euro, ndërsa buxheti final 10.171.000 euro dhe se 9.318.000 euro janë shpenzuar për paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe kapitale, transfere dhe subvencione dhe ngjashme. Buxheti fillestar për të hyrat vetanake ka qenë 2.181.000 euro, ndërsa buxheti final ka qenë 2.306.000 euro dhe prej tyre janë realizuar 2.661.000 euro dhe për atë diferencë duhet të rrisim buxhetin pasi ta marrim konfirmimin nga Ministria e Financave.

Kryesuesi pyeti nëse komuna ka pranuar ndonjë pagesë me aktvendime gjyqësore?

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se një pagesë në vlerë prej 104.000 euro është kryer nga Thesari në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës. “Nesër planifikoj të bëj kërkesë në Thesar për tërheqjen e dokumentit për të parë se për çfarë bëhet fjalë, por sipas disa informatave bëhet fjalë për shpronësimin që është bërë në vitin 2017 apo 2018 në emër të Jovan Kostiqit. Pagesa e dytë në shumën 265 euro i referohet taksës së ngarkuar gabimisht, ku pala ka paditur dhe ka fituar komunën në gjykatë”.

Asambleti Vlladica Gjurçiq, para partisë “SRPSKA”, tha se në raportin vjetor financiar thuhet se kundër Komunës së Graçanicës zhvillohen 84 konteste, prej të cilave për 18 konteste e dimë vlerën, ndërsa për 66 nuk e dimë vlerën. Ai pyeti se kush po bën këtu gabime, a është dikush përgjegjës për këtë dhe ku po gabojmë.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se në faqen 22 të raportit, neni 18 - Detyrimet e mundshme - janë ndarë 109.967 euro për paga dhe mëditje. Bëhet fjalë për punëtorët që janë shkarkuar nga puna dhe të cilët e kanë paditur komunën, pra bëhet fjalë për çështjet gjyqësore që janë duke u zhvilluar nga viti 2010.

Asambleti Vlladica Gjurçiq, para partisë “SRPSKA”, tha se nëse një punëtor është shkarkuar pa të drejtë nga puna, atëherë ai udhëheqës duhet të bartë disa përgjegjësi. Ai e pyeti drejtorin se sa ka shpenzuar komuna për dreka, përkatësisht sa mjete i takojnë drejtorëve për dreka zyrtare dhe shpenzime të udhëtimit?

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se për dreka zyrtare janë shpenzuar 59.600 euro, ndërsa të dhënat për mëditjet do t'i japë gjatë mbledhjes.

Asambleti Millosh Todoroviq, para partisë “SRPSKA”, i kërkoi drejtorit të sqarojë projektet që janë në raport nën “Aneks - Kompensimi sipas Ligjit për mbështetjen e punëve publike”. Ai pyeti se a do të realizohen projektet “Ndërtimi i aneksit të objektit të shkollës në Preoc” dhe “Ndërtimi i kaldajes në shkollën në Gushtericën e Poshtme”.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se në vitin 2023 ka ekzistuar Ligji për Inflacionin, ku ka pasur rritje të çmimeve të materialeve ndërtimore për ndërtim, kështu që ne kemi qenë të detyruar t'i paguajmë kontraktorit për punët e kryera më parë, ndërsa mjetet i kemi marrë nga ato projekte. Lista e projekteve që janë atje nuk do të realizohet për momentin dhe pas rritjes së buxhetit ekziston mundësia që disa mjete të kalojnë në ato projekte.

Asambletja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, e pyeti drejtorin Niçiq se cili është problemi më i madh në buxhetin e Komunës së Graçanicës?

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se nuk ka problem, e vetmja gjë është që kemi më shumë të hyra dhe se buxheti është më i madh.

Kryesuesi i bëri vërejtje publike asamblistit Jevtiq për ndërhyrjen në prezantimin e drejtorit Niçiq.

Kryesuesi e pyeti drejtorin nëse mjetet mund të merren nga kodi i mallrave dhe shërbimeve dhe jo nga kodi i projekteve që janë ndarë për arsim.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se të gjitha këto janë projekte kapitale, kështu që duhet të paguhet mjetet nga projektet kapitale.

Kryesuesi pyeti se kush e kontrollon sipërfaqen e bizneseve në magjistralë, sepse sipas disa informatave, aty askush nuk e bënë matjen e sipërfaqes së objekteve, por pagesa e saj bëhet paushall.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se matja bëhet nga Shërbimi i Tatimit.

Kryesuesi tha se në mbledhjen e radhës do të ftohet shefi i Tatimit për t'i bërë këtë pyetje.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për miratimin e marrëveshjes kornizë për bashkëpunim ndërkomunal shumëfunktional, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Leutrim Ajeti, nënkryetar i komunës për komunitete, ka sqaruar se vitin e kaluar Kuvendi i Komunës ka marrë vendim për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal dhe tani duhet të merret vendimi për miratimin e Marrëveshjes kornizë për bashkëpunim shumëfunktional ndërkomunal ndërmjet gjashtë komunave, përkatësisht: Graçanicës, Prishtinës, Lipjanit, Obiliqit, Fushë Kosovës dhe Podujevës, të gjitha me qëllim të rregullimit të problemeve të përbashkëta të qytetarëve dhe problemeve komunale, siç janë qentë endacak, deponitë e egra, transporti, infrastruktura dhe të ngjashme.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para parties “SRPSKA”, tha se shpreson se nga kjo marrëveshje do të dalë diçka dhe se vetë Leutrimi do të kontribuojë në bashkëpunimin ndërkomunal, duke pasur parasysh se nuk kontribuon për një jetë më të mirë, paqe dhe siguri në Kishnicë.

Kryesuesi i bëri vërejtje verbalisht asamblistes Jovanoviq, sepse po del jashtë kornizës së kësaj pike.

Leutrim Ajeti, nënkryetar i komunës për komunitete, i është përgjigjur asamblistes Jovanoviq se nëse ajo mendon se ai nuk është personi që kontribuon për paqe, është e lirë t'i ofrojë dëshmitë e saja për ta mbështetur mendimin e saj.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi me votat e 14 asamblistëve “Pro” dhe 5 vota “Abstënim” të Sllagjanës Rashiq, Sonjës Odalloviq, Bojan Zhiviqit, Jellenës Dimitrijeviq dhe Vlladica Gjurçiqit, miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës për vitin 2023, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq, tha: “Ne kryejmë aktivitete që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe përmirësimin e procesit arsimor në shkollat parashkollore, fillore dhe të mesme. Çdo vit ne investojmë në mallra dhe shërbime, projekte

kapitale dhe shërbime komunale, si dhe ofrojmë mbështetje të caktuar logjistike për institucionet, organizatat sportive dhe shtëpitë e kulturës. Buxheti për kategorinë mallra dhe shërbime ishte 160,806,00 euro, ndërsa fondi nga grantet e Qeverisë për investime kapitale ishte 312,706,00 euro. Vitin e kaluar ishin planifikuar të realizohen 13 projekte, por 5 u anuluan për shkak të tarifës së kompensimit që diskutuat sot në pikën e dytë. Fondi për shpenzime komunale ishte 40.000 euro. Gjatë periudhës raportuese janë pranuar 28 kërkesa për verifikim, ndërsa Komisioni për verifikim ka dorëzuar 27 certifikata të verifikimit të diplomës të realizuara me sukses, por nga ky numër, një numër i certifikatave i referohet kërkesave që janë dorëzuar gjatë mandatit të komisionit të kaluar.

Asambleti Millosh Todoroviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti se për cilat institucione bëhen këto verifikime.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niqiq, u përgjigj se verifikimet bëhen për universitetet e arsimit të lartë që i përkasin Mitrovicës së Kosovës.

Asambleti Granit Gashi, para partisë “ALIANCA SHQIPTARE”, pyeti se ku janë sistemuar 28 punëtorë, të cilët janë punësuar si mësimdhënës dhe profesorë vitin e kaluar përmes konkursit.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niqiq, u përgjigj se të gjithë punëtorët janë të angazhuar, disa në vetë Drejtorinë e Arsimit dhe disa janë sistemuar në komunë.

Asambleti Granit Gashi, para partisë “ALIANCA SHQIPTARE”, pyeti se mbi çfarë baze ligjore një zyrtar publik punon si shërbyes civil.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niqiq, u përgjigj se për shkak të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, në Komunën e Graçanicës ka pasur një numër më të vogël të punëtorëve administrativë, për këtë arsye sipas nevojës angazhohen punëtorët të cilët janë sistemuar përkohësisht.

Asambleti Granit Gashi, para partisë “ALIANCA SHQIPTARE”, tha se sipas raportit të ministrisë, në Drejtorinë e Arsimit ka 356 punëtorë, disa prej tyre nuk punojnë dhe rinë në shtëpi.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niqiq, u përgjigj se në Drejtorinë e Arsimit janë 239 punëtorë dhe të gjithë punëtorët janë të angazhuar diku.

Asambleti Granit Gashi, para partisë “ALIANCA SHQIPTARE”, tha se Ministria e Arsimit ka 3 vite që ka buxhet për ndërtimin e shkollës në Çagllavicë. “Pse nuk ka filluar procedura për ndërtimin e asaj shkolle?”

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niqiq, u përgjigj se nuk ka marrë asnjë informatë lidhur me ndërtimin e asaj shkolle.

Kryesuesi shtoi se komuna nuk posedon parcelë përkatëse në Çagllavicë për ndërtimin e shkollës në fjalë. Kërkesa duhet të inicohet nga ministria dhe jo nga komuna.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niqiq, u përgjigj se problemi me të cilin po ballafaqohen aktualisht është rryma. Transformatori që është instaluar, KEDS-i nuk e lejon kycjen në të, si dhe regjistrimin e njehsorit, sepse në të njëjtin transformator janë të lidhura 3 objekte banesore.

Kryesuesi shtoi se sipas disa informatave në objekt është thyer një tra mbajtës, ndaj duhet ta hetojnë edhe këtë.

**Asamblisti Granit Gashi mungon në mbledhje, të pranishëm janë 18 asamblastë dhe ka kuorum.**

Asamblisti Vlladica Gjurçiq, para partisë “SRPSKA”, e falënderoi drejtoreshën për pajisjen e kabinetit të Shkollës fillore në Gushtericën e Poshtme.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niiq, shtoi se Komuna e Graçanicës (Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik) në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) kanë siguruar pajisje për kabinetin.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë “SRPSKA”, tha se edhe shkollat e tjera në territorin e Komunës së Graçanicës do të duhej të marrin pajisje për mësim.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti a ekziston Shtëpia e kulturës e Graçanicës në Graçanicë pranë Komunës së Graçanicës në sistemin e Kosovës.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niiq, u përgjigj se janë nëntë shtëpi të kulturës.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti a janë 9 drejtorë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niiq, u përgjigj se nuk kanë drejtorë dhe se kanë vetëm një numër të caktuar punëtorësh.

Kryesuesi pyeti nëse ka pasur mundësi që këtë vit të realizohet projekti “Ndërtimi i kaldajes në shkollën fillore në Gushtericën e Poshtme”, i cili është anuluar në emër të kompensimit të inflacionit, sepse është prioritet, sepse ekziston rreziku nga shpërthimi në dhomën ekzistuese të kaldajes.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niiq, u përgjigj se pas ribalancimit të buxhetit do të bëjnë përpjekje për realizimin e projekteve të anuluar dhe mbi të gjitha projektin “Ndërtimi i kaldajes në Shkollën fillore në Gushtericën e Poshtme”.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 asamblastëve “Pro”, miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Informata për përfundimin e gjësmëvjektorit të parë dhe fillimit të gjësmëvjektorit të dytë shkollor 2023/2024, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niiq.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niiq, prezantoi informacionin se gjësmëvjektorit i parë në shkollat, ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe, ka

përfunduar më 29.12.2023. dhe gjysmëvjetori i dytë filloi më 22.01.2024. Gjysmëvjetori i parë në shkollat, ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, ka përfunduar më 12.01.2024, ndërsa gjysmëvjetori i dytë filloi më 24.01.2024. Mësimi po zhvillohet pa probleme, institucionet arsimore kanë një sasi të caktuar të mjeteve për ngrohje, ndërsa Drejtoria e Urbanizmit ka vazhduar me shënjimin e vendkalimeve për këmbësorë dhe vijave të bardha, me theks të veçantë pranë shkollave dhe parashkollorëve këtë herë në Llapllasellë, Lepinë dhe Radevë.

Kryesuesi i kërkoi drejtoreshës që ta paraqesë në kolegjiun problemin e vendkalimit të parkimit pranë Qendrës së shkollave të mesme në Llapllasellë, në mënyrë që të parandalohet ndonjë tragjedi. Është e nevojshme të vendosen tamponë, një urë mbi lumin Graçanka dhe një rampë.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë “SRPSKA”, shtoi se Qendra e shkollave të mesme është hapur në mars të vitit 2022, ndërsa edhe më parë është folur me ish-drejtorin e Urbanizmit për rregullimin e atij parkingut, por fatkeqësisht asgjë nuk është bërë.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve Evropiane, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve Evropiane, Nebojsa Millovanoviq.

Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve Evropiane, Nebojsa Millovanoviq, tha: “Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Integritime Evropiane përbëhet nga zyrtarët e mëposhtëm: zyrtari për projekte dhe integritime evropiane, zyrtar për regjistrimin e subjekteve afariste, zyrtar për efikasitet të energjisë, zyrtar për hartimin e projekteve dhe dokumentacionit të projekteve dhe Drejtoria QZHEG (Qendra për Zhvillim Ekonomik Graçanicë). Duke qenë se drejtoria nuk ka buxhet të vetin, ne shkojmë vetëm për bashkëfinancim me donatorë potencialë. Unë kam kërkuar vazhdimisht nga drejtori i financave që një pjesë të mjeteve nga kodi i subvencione t'i ndajë përmes kabinetit, por kam marrë përgjigjen se ato mjete nuk mund t'i shpenzojmë për t'i ndihmuar biznesmenët tanë. Të ardhurat e drejtorisë për vitin e kaluar ishin 5800 euro, duke u bazuar në lejet e lëshuara të punës dhe taksën e veprimtarisë. Janë regjistruar 125 biznese të reja, janë mbyllur 3 biznese dhe janë bërë 200 ndryshime dhe kemi lëshuar 183 certifikata për ndihmë sociale. Në bashkëpunim me UNDP-në Kosovë jemi duke punuar në zhvillimin e Planit lokal të veprimtimit për cilësinë e ajrit në Komunën e Graçanicës, i cili financohet nga Qeveria e Luksemburgut. Në bazë të atij plani, shpresoj se do të mund të zbatojnë disa tema më problematike, siç është Djerrina dhe lumi Graçanka. Një nga donatorët më cilin kemi një bashkëpunim të shkëlqyeshëm është organizata e IOM-it, por që nga ky vit ai program po mbyllet, për faktin se BE-ja vendosi sanksione ndaj Kosovës”. Në vijim, drejtori nga raporti lexoi memorandumet e nënshkruara të bashkëpunimit për projektet e realizuara, duke i përfshirë edhe projektet që do të realizohen në të ardhmen.

Asamblisti Dejan Jevtiq, para partisë “SRPSKA”, e pyeti drejtorin nëse mund të merrte pjesë në mbledhjen e radhës të Komitetit për Komunitete, në mënyrë që ata të mund të shihnin nëse ekzistonte mundësia dhe mënyra për t'i ndihmuar komunitetet.

Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Integritime Evropiane, Nebojsa Millovanoviq, u përgjigj se duhet t'i dërgojnë ftesë dhe se ai do të marrë pjesë në mbledhjen e radhës.

Kryesuesi pyeti se cili komision përcakton se cilat projekte duhet të bashkëfinancohen.

Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve Evropiane, Nebojsa Millovanoviq, u përgjigj se donatorët kërkojnë që komuna të marrë pjesë në disa projekte. Grantet që u jepen privatëve për të hapur biznese të vogla, në përqipimi të japim maksimumin tonë, që në total të marrim një numër të barabartë grantesh.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se deri ku ka arritur projekti "Ndërtimi i Qendrës Arsimore dhe Rekreative" në Graçanicë, i cili duhet të realizohet me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.

Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve Evropiane, Nebojsa Millovanoviq, u përgjigj se komuna ka paguar një pjesë të bashkëfinancimit vitin e kaluar dhe vlera e tërë projektit është 328,000,00€.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se cilat janë mundësitë për realizimin e projektit: "Ndërtimi i kolektorëve të ujërave të zeza për zonat e biznesit të Graçanicës dhe Lipjanit", vlera e projektit: 722,702,30€.

Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve Evropiane, Nebojsa Millovanoviq, u përgjigj se Ministria e Zhvillimit Rajonal e ka pranuar projektin, por shuma me të cilën komuna do të bashkëfinancojë ende nuk është përcaktuar. Komuna e Lipjanit është bartëse e atij projekti, me të cilën Komuna e Graçanicës ka nënshkruar memorandum.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", tha se drejtorja duhet ta ketë buxhetin e vet që të realizojë vetë ndonjë projekt, p.sh. për ndërtimin e fermës së pulave. Ajo pyeti se si funksionojnë drejtoritë e Zhvillimit Ekonomik në komunat tjera dhe a e kanë ato buxhet të vet.

Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve Evropiane, Nebojsa Millovanoviq, u përgjigj se komuna nuk mund të ndajë mjete nga projektet kapitale dhe të ndërtojë p.sh. një fermë pulash, sepse dikush duhet ta menaxhojë atë dhe komuna nuk mundet. Drejtorja mund ta përdorë kodin vetëm nga subvencionet, por ai kod është shumë i vogël dhe komuna nuk mund ta rrisë kodin sa të duam.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", shpjegoi se kur e ka marrë si shembull ndërtimin e fermës së pulave, nuk ka menduar që të ndërtohet shtëpia për ta, por se komuna duhet ta ndërtojë infrastrukturën. "Unë mendoj se ka një mënyrë, por nuk ka vullnet të mirë".



**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 asamblastëve “Pro”, miratoi pikën e gjashtë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit preliminar për fillimin e procedurës për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër – lokalet në Suhadoll, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, e shpjegoi propozimin e vendimit për fillimin e procedurës për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër – objektet në Suhadoll, duke u kujtuar asamblastëve se në fund të vitit të kaluar kanë marrë vendim për miratimin e listës së pronës së paluajtshme të komunës, të cilën komuna planifikon të japë me qira. Të dy objektet ndodhen në Suhadoll dhe janë të destinuar për funksionimin e objekteve të tregut dhe hotelierisë për shfrytëzim afatshkurtër për një periudhë 3-vjeçare.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Kryesuesi ka propozuar që asamblastët Millosh Dimiq dhe Marko Arsiq të jenë në Komisionin vlerësues.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri me votat e 18 asamblastëve “Pro” miratoi propozimin e kryesuesit dhe në Komisionin vlerësues emëroi asamblastët Millosh Dimiq dhe Marko Arsiq.**

Kryesuesi propozoi që Komisioni për shqyrtimin e ankesave të përfshijë asamblastët e Kuvendit, Stefan Mitroviq dhe Biljana Kapetanoviq.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri me votat e 18 asamblastëve “Pro” miratoi propozimin e kryesuesit dhe në Komisionin për shqyrtimin e ankesave emëroi asamblastët, Stefan Mitroviq dhe Biljana Kapetanoviq.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Të ndryshme.

Kryesuesi pyeti nëse ka mundësi që këtë vit me ribalancimin e buxhetit të përfundohet projekti i rregullimit të parkingut, stacionit të autobusëve dhe ndërtimi i urës mbi lumin Graçanka pranë Qendrës së shkollave të mesme. Projekti është prioritar për sigurinë e vetë fëmijëve dhe kërkesa i është dërguar drejtoreshës së mëparshme, por nuk është bërë asgjë lidhur me këtë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, propozoi që në mbledhjen e radhës të Kuvendit t'i dorëzojë informatata e sakta.

Asambleti Zoran Danilloviq, para parties "SRPSKA", tha se në Sushicë, në qendër të fshatit, ekziston një gropë në rrugë, ndërsa policët e shtrirë që janë të vendosur në Llapllasellë nuk janë të shënuar.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se Ujësjetllësi ka shkaktuar dëm në asfaltin e ri.

Asambleti Marko Arsiq, para parties "SRPSKA", tha se parku në Batushë është duke u ndërtuar më shumë se gjashtë muaj dhe ende nuk është përfunduar. Kontraktori la një gropë të hapur në atë park me tela elektrikë të dalë jashtë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se është bërë prerja e situatës dhe se deri ku ka arritur do ta shohë me menaxherët e projektit.

Asambleti Dragan Maksimoviq, para parties "SRPSKA", pyeti se kur priten punimet në shkollën fillore "Knez Lazar" në Gushtericën e Poshtme.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se pritet ribancimi i buxhetit si dhe projekti për kaldajën ekziston.

Asambleti Stefan Mitroviq, para parties "SRPSKA", shtroi pyetje lidhur me gropat, përkatësisht pyeti a ka dalë organi mbikëqyrës gjatë kryerjes së punimeve që zhvillohen në drejtim të Marigonës dhe cili ka qenë konkluzioni. Si dhe pyeti për çfarë arsye punimet nuk kanë vazhduar në drejtim të Lepinës, ndërsa asfalti që është shtruar është i cilësisë së dobët dhe ka filluar të konsumohet.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se menaxherët e projektit janë përgjegjës për kryerjen e punimeve. Nuk kemi vazhduar me punimet sepse kemi problem me pagesën sepse tani është në fuqi një ligj i ri.

Asambleti Vlladica Gjurçiq, para parties "SRPSKA", tha se rruga kryesore në Dobrotin është në një gjendje katastrofike dhe se ka shumë gropa. Ai pyeti nëse duhet të bëjë një kërkesë, sepse e sheh se kryetari i fshatit nuk po punon asgjë lidhur me këtë çështje.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se janë pesë gropa dhe është dashur të kryhen, por është dashur të ndalemi të shohim se si mund ta paguajnë, sepse tani më nuk ekziston kodi për arnimin dhe riparimin e gropave.

Asambletja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", e pyeti drejtoreshën nëse i mbikëqyr punimet lidhur me ndërtimin e parkut të dytë në Kishnicë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se është e njoftuar në bazë të dokumentacionit të përgatitur nga menaxheri i projektit.

Asambletja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", tha se kompania që ka punuar në atë park ma ka bllokuar oborrin dhe ka shkaktuar dëme të mëdha dhe nuk ka rikthyer asgjë në gjendjen fillestare dhe ekziston mundësia që unë do ta padisë kontraktuesin dhe komunën sepse ajo i ka mbikëqyrur punimet. Ajo kompani më ka vjedhur ujin dhe rrymën nga oborri dhe më pas

nuk kanë përfunduar të gjitha punët. “Më mirë do të ishte t’i mbikëqyrnit punimet sesa ta vizitoni Panairin e Turizmit në Beograd”.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, shpjegoi se kontraktori nuk ka mundur t’i parkoi makineritë në oborrin tuaj pa lejen tuaj.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, tha se mendonte se janë makina për ndërrimin e gypave të ujit dhe pas kësaj ka kërkuar që ato makina të dalin jashtë oborrit të saj, por askush nuk e ka dëgjuar e as ka reaguuar.

Kryesuesi tha se ka një ankesë të qytetarëve që do të paraqitet, sepse kur është ndërtuar shtegu nga shkolla në Graçanicë deri te objektet në Padallishtë, uji është marrë nga një vend, por borxhet nuk janë kompensuar. Kontraktori dhe menaxheri i projektit janë informuar disa herë verbalisht, por nuk ka pasur përgjigje.


Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë “SRPSKA”, parashtrroi pyetjen: “Deri ku ka arritur marrëveshja për zgjerimin e varrezave? Kërkoj që të gjendet një zgjidhje teknike për parkimin ekzistues të autobusëve pranë Qendrës së shkollave të mesme dhe zgjerimin e parkingut, si dhe shtegun e këmbësorëve nga kisha deri te banesat në Llapllasellë, sepse kemi folur për ato projekte gjatë prezantimit të buxhetit të vitit të kaluar”.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se për ato projekte ka biseduar me kryetarin e Këshillit lokal të Llapllasellës dhe shpreson që këtë vit do ta përfundojnë parkingun. Për sa i përket zgjerimit të varrezave, familja aktualisht është në proces të zgjidhjes së marrëdhënieve pronësore dhe pas përfundimit të procesit mund të inicojnë fillimin e shpronësimit.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se në mbledhjen e sotme, asamblisti Gjurçiq kërkoi të dhëna për dreka dhe mëditje zyrtare, duke sqaruar se me vendim të kryetares, prezantimi mund të shpenzohet pafundësisht nga Kabineti, ndërsa të gjithë drejtorët, asamblistët e Kuvendit dhe nënkryetarët mund të shpenzojnë nga 50 euro në nivel mujor. Gjithsej në nivel vjetor janë shpenzuar 59.600 euro, duke përfshirë edhe drekat e Kuvendit. Kemi dy kategori mëditjesh: brenda dhe jashtë vendit. Brenda vendit janë shpenzuar 220 euro, ndërsa jashtë vendit kemi dy kategori, nëse punonjësit iu është siguruar ushqimi dhe akomodimi merr vetëm mëditje dhe për këtë janë shpenzuar 2.820 euro, kurse kur atij nuk iu është siguruar akomodimi, ushqimi dhe transporti, janë shpenzuar 21.880 euro. Raporti i është përcjellë Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm si dhe Thesarit, i cili do ta monitorojë korrektësinë e Pasqyrave vjetore financiare.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 12:05.

Procesmbajtësi:  
Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milan Dimitrijević